



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 60

2003

Korrik

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.388, datë 12.6.2003	Për ngritjen e Komisionit Shtetëror për kualifikimin e auditëve të brendshëm në sektorin publik.....	2525
Vendim i KM nr.389, datë 12.6.2003	Për përcaktimin e vjetërsisë në punë, për marrjen e titullit të përkohshëm “Audit i brendshëm në sektorin publik”...	2526
Vendim i KM nr.481, datë 10.7.2003	Për kalimin e një pjese të territorit të QSUT-së në administrim të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH).....	2527
Vendim i KM nr.486, datë 10.7.2003	Për miratimin e Marrëveshjes së koncesionit të formës “ROT” ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës dhe shoqërisë “AMAL” sh.p.k. për hidrocentralin vendor të Xhyrës.....	2529
Vendim i KM nr.487, datë 3.7.2003	Për disa ndryshime në vendimin nr.155, datë 13.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e shpenzimeve të atashëve ushtarakë dhe oficerëve të forcave të armatosura, që shërbejnë në shtabet e NATO-s”.....	2537

Vendim i KM nr.488, datë 10.7.2003	Për shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme, që preket nga ndërtimi i sheshit për dekompozimin e mbetjeve urbane në Bashkinë e Fushë-Krujës.....	2537
Vendim i KM nr.489, datë 10.7.2003	Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Ushqimin dhe Ushqyerjen.....	2538
Udhëzim i ME nr.106, datë 1.7.2003	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.230, datë 4.4.1998 “Për privatizimin e pjesëve të kapitalit të zotëruara nga shteti në shoqëritë me kapital të përbashkët”	2539
	Kërkese për shpronësimin e pasurive pronë e paluajtshme për objektin “Për ndërtimin e Qendrës Kombëtare Stërvitore Bazë (QKSB) të FA-së të Republikës së Shqipërisë në rajonin Bunavi”.....	2540
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Petrit Loshi...	2541

V E N D I M
Nr.388, datë 12.6.2003

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT SHETETËROR PËR KUALIFIKIMIN E AUDITËVE TË
BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të fundit të shkronjës “b” të nenit 13 të ligjit nr.9009, datë 13.2.2003 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ngritjen e Komisionit Shtetëror për kualifikimin e auditëve të brendshëm, me këtë përbërje:
 - një pedagog të financave publike;
 - një pedagog nga fusha e kontabilitetit;
 - një pedagog nga fusha e makroekonomisë;
 - Kryetarin e Këshillit të Drejtimit të IEKA-së;
 - një audit nga KLSH-ja;
 - një avokat;
 - Drejtorin e Përgjithshëm të Auditimit të Brendshëm.
2. Drejtori i Përgjithshëm i Auditimit të Brendshëm, cakton sekretarin e komisionit dhe nënkomisionet për çdo lëndë, me pjesëmarrjen e detyrueshme të njërit prej anëtarëve të komisionit, të përcaktuar në pikën 1, i cili kryen funksionin e kryetarit të nënkomisionit.
3. Certifikimi i auditëve të brendshëm në sektorin publik parashikon likuidimin e detyrimeve për çdo lëndë, si dhe provimin e formimit, i cili mund të jetë edhe në formën e mbrojtjes së temave të caktuara. Mbrojtja e temës ose provimi i formimit bëhet para komisionit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi. Provimi i formimit ose mbrojtja e temës bëhet jo më vonë se 60 ditë nga likuidimi i provimeve të lëndëve përkatëse.
4. Komisioni harton programin mbi të cilin testohen auditët e brendshëm publik. Programi përmban drejtimit, lëndët dhe temat për të cilat përgatiten dhe japin provim auditët e brendshëm.
Komisioni mund ta ndajë programin në dy ose më shumë lëndë, sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Auditit.
5. Kandidati, për t’u regjistruar, duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në ligjin nr.9009, datë 13.2.2003 “Për auditimin e brendshëm”. Kriteret shpallen jo më vonë se 60 ditë përpara provimit.
Verifikimi i kriterëve bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit të Brendshëm, jo më vonë se 10 ditë pas mbarimit të afatit të paraqitjes së dokumenteve, e cila shpall listën e personave që i plotësojnë kriteret dhe që mund t’u nënshtrohen provimeve.
Kandidatët duhet të regjistrohen brenda 15 ditëve nga shpallja e listave, duke plotësuar të gjitha detyrimet financiare, që rrjedhin nga regjistrimi. Personat që kanë kundërshtime për shpalljen e listave mund të ankohen te Drejtori i Përgjithshëm i Auditimit të Brendshëm, brenda 5 ditëve nga shpallja e listave. Vendimi i drejtorit është përfundimtar.
6. Provimi i auditëve zhvillohet me shkrim dhe me gojë, sipas rregullave të përcaktuara nga komisioni dhe të miratuara nga Ministri i Financave.
7. Vlerësimi i kandidatëve në provim bëhet me pikë. Kandidati për t’u kualifikuar duhet të fitojë më shumë se 50 pikë për çdo lëndë. Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve për çdo lëndë, është mesatarja aritmetike e pikëve të dhëna nga secili anëtar i komisionit.
8. Komisioni, gjatë vlerësimit, nuk duhet të njohë identitetin e kandidatit. Komisioni, për këtë qëllim, përcakton një skemë të njëjtë me provimet e pranimit në shkollat e larta.
9. Gjatë një sezoni provimesh mund të ketë disa data provimesh, në varësi të kandidatëve të regjistruar. Një provim mund të jepet si riprovim brenda të njëjtit sezon, por jo më vonë se 45 ditë nga data e provimit.
10. Kandidati mund të certifikohet si audit i brendshëm, nëse ka likuiduar të gjitha detyrimet që përcakton programi. Programi konsiderohet i vlefshëm vetëm për një vit kalendarik. Komisioni vendos nëse ndryshimet në program kërkojnë dhënien e riprovimit nga kandidatët, të cilët nuk i kanë

likuiduar të gjitha detyrimet brenda vitit kalendarik.

11. Kandidati mund t'i nënshtrohet të njëjtit provim disa herë.

12. Për çdo regjistrim fillestar, provim dhe riprovim kandidatët duhet të paguajnë një tarifë, sipas përcaktimit të bërë nga Ministri i Financave.

Të gjitha shpenzimet që bëhen për kualifikimin e kandidatëve, si ndjekja e seminarëve, shpenzimet për libra, leksione e programe etj., përcaktohen nga kandidatët, sipas tarifave të përcaktuara nga Ministri i Financave.

13. Kualifikimi i kandidatit si "Audit i brendshëm në sektorin publik" vërtetohet me certifikatë, forma e së cilës përcaktohet nga Ministri i Financave dhe nënshkruhet nga Ministri i Financave.

14. Anëtarët e komisionit, për punën që kryejnë, shpërblehen, sipas përcaktimeve të bëra nga Ministri i Financave, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm. Shpenzimet përkatëse përballohen nga Ministria e Financave.

15. Ministri i Financave, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, përcakton përbërjen e anëtarëve të komisionit dhe cakton kryetarin.

16. Punonjësit e punësuar në strukturat e auditimit të brendshëm dhe që nuk kanë vjetërsinë në punë, sipas përcaktimeve të bëra nga Këshilli i Ministrave, do t'u nënshtrohen provimeve të kualifikimit, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Kur kandidati merr pjesë në provim, por nuk e fiton titullin "Audit i brendshëm", ai ka të drejtë t'u nënshtrohet edhe një herë provimeve, brenda 60 ditëve. Kur, edhe në këtë rast, nuk e fiton titullin përkatës, por është nëpunës civil, zbatohen kushtet e nenit 24 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", ndërsa në rastet e tjera ndërpriten marrëdhëniet e punës.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.389, datë 12.6.2003

PËR PËRCAKTIMIN E VJETËRSISË NË PUNË, PËR MARRJEN E TITULLIT TË PËRKOHSHËM "AUDIT I BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "b" të nenit 13 të ligjit nr.9009, datë 13.2.2003 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Specialistët dhe drejtuesit e njësive të kontrollit të brendshëm, që në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr.9009, datë 13.2.2003, janë të punësuar dhe kanë një vjetërsi pune prej 4 vjetësh në këto struktura ose në Kontrollin e Lartë të Shtetit, marrin titullin e përkohshëm "Audit i brendshëm në sektorin publik", sipas përcaktimeve të shkronjës "b" të nenit 13 të këtij ligji.

2. Vendimi nr.217, datë 5.5.2000 i Këshillit të Ministrave "Për kontrollin financiar", shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë udhëzimin përkatës për përcaktimin e procedurave të hollësishme për zbatimin e pikës 1 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.481, datë 10.7.2003

**PËR KALIMIN E NJË PJESE TË TERRITORIT TË QSUT-SË NË ADMINISTRIM TË
INSTITUTIT TË SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR (ISKSH)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kalimin e një pjese të territorit të QSUT-së prej 1 500 m² në administrim të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, sipas planimetrisë dhe genplanit, që i bashkëlidhen këtij vendimi, për ndërtimin e mjediseve të zyrave të këtij instituti.


2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe QSUT-ja, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

PLANIMETRIA E TERRITORIT TE VENDOSJES SE ISKSH

SHKALLA 1 : 500



MIRATO HET
DREJTORI I PERGJITHSHEM I QSUT
MIHAL TASE
7.10.2019

V E N D I M
Nr.486, datë 10.7.2003

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË KONCESIONIT TË FORMËS “ROT”
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË DHE MINISTRISË SË INDUSTRIËS DHE TË
ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË “AMAL” SHPK PËR HIDROCENTRALIN VENDOR
TË XHYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7, 9 dhe 10 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë” dhe të nenit 2 të ligjit nr.8527, datë 23.9.1999 “Për privatizimin e hidrocentraleve vendore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e Marrëveshjes së koncesionit të formës “ROT” ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës dhe shoqërisë “AMAL” sh.p.k. për hidrocentralin vendor të Xhyrës, në rrethin e Librazhdit.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
KONCESIONI PËR HIDROCENTRALIN VENDOR XHYRË
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË DHE MINISTRISË SË INDUSTRIËS
DHE TË ENERGJETIKËS

Më poshtë referuar si Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) dhe shoqërisë “AMAL”sh.p.k. Librazhd, përfaqësuar nga z.Agim Elezi, më poshtë referuar si “Koncesionari”.

Meqenëse ekzistojnë këto kushte paraprake, Qeveria shqiptare:

- konsideron privatizimin e sektorit elektroenergjetik si një mjet të rëndësishëm të politikës energjetike dhe konfirmon një interes të lartë në privatizimin e hidrocentraleve vendore, për të rehabilituar asetet publike të tyre (objektet dhe makineritë) që janë degraduar;

- vlerëson formulën e koncesionit ROT, sepse kjo bën të mundur rehabilitimin e hidrocentraleve vendore pa prekur Buxhetin e Shtetit;

- mirëpret investitorët vendas në rehabilitimin, ruajtjen e aseteve dhe të kapaciteteve prodhuese të hidrocentraleve vendore, si dhe në fuqizimin e disa prej tyre;

- është e prirur për ngritjen dhe zhvillimin e tregut të energjisë elektrike brenda vendit dhe autorizon KESH sh.a-në si të vetmin blerës aktual të energjisë elektrike, të nënshkruajë një kontratë blerjeje me Koncesionarin;

- autorizon, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.90, datë 13.2.2003 “Për fillimin e procedurës së dhënies me koncesion në formën ROT të hidrocentralit vendor Xhyrë”, Ministrinë e Ekonomisë dhe Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës të negociojnë dhe të nënshkruajnë Marrëveshjen e koncesionit.

Koncesionari:

- është seriozisht i interesuar të investojë në fushën e elektroenergjetikës;

- ka ndërmarrë studimin tekniko- ekonomik për rehabilitimin dhe shfrytëzimin e hidrocentralit, objekt i koncesionit;

- konsideron që iniciativa mund të bëhet e suksesshme në kushte të caktuara stabiliteti

shoqëror- ekonomik;

- është i aftë të rehabilitojë dhe të menaxhojë hidrocentralin vendor, objekt i koncesionit.

Palët:

- bien dakord që të bashkëpunojnë për mbarëvajtjen e koncesionit për këtë hidrocentral, si në fazën e rehabilitimit, ashtu edhe gjatë shfrytëzimit.

Palët ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

Kudo që në këtë kontratë përdoren termat e mëposhtëm, ato do të kenë kuptimet përkatëse të shënuara:

Marrëveshja e koncesionit: Kjo Marrëveshje.

Kontratat: Të gjitha kontratat që mund të lidhen në të ardhmen nga Koncesionari.

Ndryshimi i ligjit: Do të thotë çdo akt që ka karakter rregullator ose ligjor të miratuara nga autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë ose që ka hyrë në fuqi pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA): Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës.

Lejet: Lejet, licencat, autorizimet dhe koncesionet që Koncesionari mund t'ua kërkojë autoriteteve kompetente në Republikën e Shqipërisë, për zbatimin e plotë të Projektit, si dhe për stafin e vet, në bazë të ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Koncesionari: "AMAL" sh.p.k. Librazhd.

Hidrocentrali: Përcaktohet me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.90, datë 13.2.2003 "Për fillimin e procedurës së dhënies me koncesion në formën ROT të hidrocentralit vendor Xhyrë".

Projekti: Studimi tekniko-ekonomik për rehabilitimin e hidrocentralit vendor Xhyrë (Librazhd) dhe në përputhje me formën ROT (Rehabilitim – Shfrytëzim – Transferim).

Fillimi i Projektit: Janë veprimtaritë (verifikimi i gjendjes aktuale, marrja në dorëzim e hidrocentraleve, programimi i rivënies në punë), që do të kryhen nga OSHA-ja, Koncesionari dhe KESH-i, për të bërë të mundur fillimin e implementimit të projektit.

Neni 2

Objekti i koncesionit

Objekt i kësaj Marrëveshjeje është dhënia me koncesion e hidrocentralit Xhyrë (Librazhd), në përputhje me formën ROT:

- rehabilitimi në parametrat e projektuar i tërësisë fizike të objektit;
- operimi optimal tekniko-ekonomik për prodhimin e energjisë elektrike;
- transferim shtetëror të tërësisë fizike dhe aseteve të rehabilituara të objektit në gjendje pune.

Neni 3

Kohëzgjatja e koncesionit

Marrëveshja e koncesionit për hidrocentralin e sipërpërmendur do të ketë një kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) vjetësh duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të saj.

Neni 4

Detyrimet e Koncesionarit

Koncesionari është i detyruar të zbatojë projektin dhe objektivat e Marrëveshjes lidhur me termat dhe kushtet e saj. Në detaje Koncesionari angazhohet që:

- Të respektojë të gjitha dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare.
- Të implementojë programin e rehabilitimit të hidrocentralit, objekt i koncesionit, për pjesën që është nën përgjegjësinë e tij, si dhe nëpërmjet bashkëpunimit aktiv me OSHA-në, sipas aneksit nr.1

dhe aneksit nr.2 bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje.

Në hidrocentralin Xhyrë do të investohen 5.45 milionë lekë në vitet 2003-2004.

- Të marrë masa me qëllim që çdo investim të jetë sipas afateve të kësaj Marrëveshjeje dhe me cilësinë e kërkuar.

- Të ruajë e të administrojë objektin e Marrëveshjes për prodhim të energjisë elektrike gjatë gjithë periudhës së koncesionit, në përputhje me specifikimet e kësaj Marrëveshjeje.

- Të punësojë personelin aktual të hidrocentralit në koncesion dhe të mbajë numrin e nevojshëm të tyre gjatë shfrytëzimit sipas legjislacionit.

- Në veprimtarinë e tij të respektojë legjislacionin në fuqi, në veçanti për fushën ku vepron, të respektojë ligjet për energjinë elektrike dhe për sektorin elektroenergjetik.

- Të marrë të gjitha masat paraprake, me qëllim që të garantojë kushte teknike për punëtorët dhe për të tretët, për të shmangur dëmet ndaj pronës publike dhe private dhe të respektojë legjislacionin në fuqi, si dhe dispozitat e tjera për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë.

- Të realizojë kontrata të përshtatshme sigurimi për të mbuluar çdo risk të mundshëm gjatë kohëzgjatjes së koncesionit, edhe ndaj palëve të treta.

- Në përfundim të afatit të koncesionit (30 vjet), Koncesionari është i detyruar t'i dorëzojë OSHA-së hidrocentralin në gjendje pune (përveç pasojave të forcave madhore), dhe me një rezervë të pjesëve të këmbimit për një vit.

Koncesionari nuk përgjigjet për të gjitha detyrimet që objektet e marra në koncesion kanë ndaj shtetit dhe të tretëve deri në hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Detyrimet e OSHA-së

Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) angazhohet të garantojë dhe të marrë përsipër detyrimet e mëposhtme:

- Të bashkëpunojë në mënyrë aktive për vërtetimin e gjendjes aktuale në të cilën ndodhet objekti i koncesionit dhe për dorëzimin e tij.

- Të ndihmojë Koncesionarin për aplikimet, marrëveshjet ose kontratat e nevojshme për zbatimin e projektit, me institucionet e tjera (ERE, K.K Ujërave, KESH).

- Të asistojë Koncesionarin në finalizimin e një Marrëveshjeje afatgjate me KESH sh.a., për shitjen e energjisë elektrike, për aq kohë sa KESH sh.a. të jetë me kapital tërësisht shtetëror.

- Të asistojë Koncesionarin pranë KESH-it për transmetimin në linjat e tensionit të mesëm të energjisë së prodhuar ose pranë institucioneve të ngarkuara, për nxjerrjen e të gjitha autorizimeve të nevojshme, lejeve të punimeve, lejeve të ndërtimeve dhe atyre të mbrojtjes së mjedisit, sipas kërkesave të bëra nga Koncesionari. Kërkesat do të jenë të përpiluara në formën që e kërkon ligji i koncesionit për të gjithë kohëzgjatjen e tij.

- Të marrë përsipër zgjidhjen e çdo problemi, që lidhet me pretendimet e personave fizikë dhe juridikë të ndryshëm për pronësinë e truallit nën objektin e dhënë në koncesion.

- Të ofrojë asistencën e nevojshme për të organizuar sigurimin fizik të objekteve të koncesionit në përputhje me legjislacionin.

- Të asistojë Koncesionarin pranë çdo organi e autoriteti shqiptar për realizimin e projektit të tij dhe t'i garantojë Koncesionarit ekskluzivitetin për realizimin e projektit mbi objektin e dhënë në koncesion, gjatë gjithë kohëzgjatjes së koncesionit.

- Të asistojë Koncesionarin në zgjidhjen e problemit të përdorimit të ujit pranë Komitetit Kombëtar të Ujërave, në përputhje me legjislacionin.

- Të ndihmojë Koncesionarin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me KESH-in dhe me institucione të tjera, pushtetin vendor etj.

- T'i dorëzohet Koncesionarit objekti i koncesionit brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6
Vlerësimi i investimeve

Investimet për rehabilitim në parametrat e projektuar, sipas projekteve teknike, sipas aneksit nr.1 dhe aneksit nr.2, janë shënuar në nenin 4. Investimet e mësipërme mund të përbëjnë objekt për ndryshime të mundshme:

- sipas rezultateve të vërtetimit të gjendjes së hidrocentralit;
- në çdo kohë, gjatë zbatimit të projektit, me marrëveshje ndërmjet dy Palëve.

Neni 7
Shitja e energjisë elektrike të prodhuar

Sipas çmimit të shitjes së energjisë elektrike të aprovuar nga ERE (Enti Rregullues i Energjisë), KESH-sh.a. është i autorizuar të firmosë me Koncesionarin një Marrëveshje afatgjatë për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar.

Neni 8
Puna, fuqia punëtore dhe riorganizimi i punës

Marrëdhëniet e punës, punësimi i personelit dhe programet e trajnimit të tyre do të realizohen në marrëveshje me autoritetet kompetente duke respektuar legjislacionin në fuqi.

Neni 9
Programi i punimeve

Palët angazhohen të respektojnë programin e mëposhtëm:

1. Koncesionari garanton aktivizimin e programit të rehabilitimit brenda një afati prej 60 ditësh, duke filluar nga data e marrjes në dorëzim të objektit të koncesionit.
2. Koncesionari garanton të përfundojë investimin brenda afateve të shënuara në nenin 4, në aneksin nr.1 dhe në aneksin nr.2.
3. Nëse Koncesionari nuk kryhen programin e investimeve sipas nenit 4 të kësaj Marrëveshjeje, OSHA ka të drejtë të prishë Marrëveshjen në mënyrë të njëanëshme. Në këtë rast, investimet e bëra nga Koncesionari deri në momentin e heqjes së koncesionit, do të mbeten pronë e OSHA-së.
4. Këto afate mund të ndryshohen me marrëveshje ndërmjet dy Palëve.

Neni 10
Zgjidhja e Marrëveshjes së koncesionit

OSHA ose Koncesionari mund të kërkojë të anulojë këtë Marrëveshje nëse Pala tjetër nuk plotëson detyrimet për zbatimin e saj.

Në rast të konfirmimit të çështjes për pretendimet e mundshme, Pala e dëmtuar do të njoftojë menjëherë për këto pretendime Palën tjetër, e cila brenda 30 ditëve, duhet të japë një përgjigje argumentuese. Në bazë të kësaj përgjigjeje, Pala e dëmtuar do të gjykojë për të filluar ose jo procedurën për zgjidhjen e Marrëveshjes.

Neni 11
Marrëveshjet e aplikuara dhe kontratat

Duke iu referuar neneve 1, 4, 5, 9 dhe 22 të kësaj Marrëveshjeje, Koncesionari do të zbatojë

projektin duke përgatitur, diskutuar, përmbushur dhe firmosur me pjesëmarrjen aktive të OSHA-së, të gjitha aplikimet, marrëveshjet dhe kontratat.

Koncesionari, për të përmbushur detyrimet e Marrëveshjes së koncesionit, është gjithashtu i autorizuar të nënshkruajë marrëveshje nënkontraktore me palë të tjera për rehabilitimin e hidrocentraleve sipas projektit.

Koncesionari do të ketë përgjegjësi ndaj OSHA-së për të gjitha punimet për rehabilitimin e hidrocentralit.

OSHA nuk ka përgjegjësi kundrejt palëve të treta, punëtorëve ose sipërmarrësve që kanë lidhje me Koncesionarin, përveç detyrimeve që OSHA ka marrë përsipër në këtë Marrëveshje.

Neni 12

Sigurimet

Koncesionari do të sigurojë me shpenzimet e veta, objektin që lidhet me projektin, për të gjithë kohëzgjatjen e koncesionit.

Me kërkesën e OSHA-së, Koncesionari do t'i japë asaj të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, që ka të bëjë me sigurimin e objektit.

Në rast se objekti i siguruar do të dëmtohet dhe është i mbuluar nga sigurimet, të ardhurat nga siguracioni do të përdoren nga Koncesionari për riparimin e objektit.

Neni 13

Riparimi dhe mirëmbajtja

Koncesionari do të kryejë me shpenzimet e veta të gjitha llojet e riparimeve dhe të mirëmbajtjes në objektin e përcaktuar në këtë Marrëveshje.

Neni 14

Kontrolli i përgjithshëm

OSHA mund të ushtrojë një kontroll të përgjithshëm gjatë operacioneve të rehabilitimit dhe të përgatitjes për punë nëpërmjet të autorizuarëve në marrëveshje të përbashkët ndërmjet Koncesionarit dhe OSHA-së, me qëllim që të verifikojë nëse punimet janë në përputhje me programin e rehabilitimit dhe me dokumentacionin e projektit.

Në rast të shkeljeve të Marrëveshjes, konstatuar gjatë kontrollit të përgjithshëm, Koncesionari do të njoftohet me shkrim dhe do të vërë në zbatim masat e nevojshme për të ardhmen.

Neni 15

Legjislacioni i zbatueshëm

Zbatimi dhe interpretimi i kësaj Marrëveshjeje koncesioni do të bazohen në legjislacionin shqiptar në fuqi.

OSHA garanton se të gjitha ligjet dhe rregullat, që eventualisht do të dalin pas nënshkrimit të kësaj kontrate, nuk do të ndryshojnë detyrimet kontraktuale të Palëve.

Neni 16

Forca madhore dhe të paparashikuara

Konsiderohen ngjarje të forcës madhore katastrofat e natyrës, përmytjet, tërmetet, ngjarjet e jashtëzakonshme politike, lufta (dhe ndërhyrja e palëve të treta që kanë fuqinë e ligjit) dhe çdo ngjarje e barabartë, që mund të ndikojë në objektin e kësaj Marrëveshjeje, duke bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve reciproke të Marrëveshjes, që kanë të bëjnë me vullnetin e Palëve.

Palët nuk do të jenë përgjegjëse nëse nuk arrijnë detyrimet e tyre në këtë Marrëveshje, si rezultat i ndikimit të forcës madhore.

Në këtë rast, kur një detyrim i kësaj Marrëveshjeje do të priset ose do të hiqet si rezultat i

forcës madhore, Pala e dëmtuar është e detyruar të njoftojë me shkrim Palën tjetër duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e punimeve ose braktisjen e tyre, si dhe masat që do të merren për të parandaluar pasojat.

Nëse gjatë implementimit të Marrëveshjes do të ketë veprim të forcave madhore, atëherë Palët mund të mos zbatojnë detyrimet e tyre; në këtë rast, nuk do të kërkohet kompensim reciprok nga Palët.

Kufijtë e ndërprerjes së punës dhe të shtyrjes në kohë të punimeve, do të konfirmohen nga Palët në një procesverbal të ngjarjes.

Si rrjedhim i ngjarjeve të shkaktuara nga një forcë madhore, kohëzgjatja e koncesionit do të shtyhet për një periudhë kohe, që caktohet me marrëveshje ndërmjet dy Palëve.

Neni 17

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së koncesionit

Marrëveshja e koncesionit do të hyjë në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët dhe pasi të jetë miratuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet dhe infrastrukturën publike”.

Neni 18

Klauzola të përgjithshme

Kjo Marrëveshje, së bashku me të gjithë dokumentacionin, është bërë në gjuhën shqipe dhe është hartuar në 7 (shtatë) kopje origjinale, 5 (pesë) prej të cilave do të merren nga Organi Shtetëror i Autorizuar dhe 2 (dy) kopje do të merren nga Koncesionari.

Neni 19

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Problemet ose mosmarrëveshjet ndërmjet Palëve, që kanë lidhje me implementimin dhe interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, nuk do të anulohen detyrimet e Palëve sipas kësaj Marrëveshjeje.

Palët janë të angazhuara të zgjidhin çdo mosmarrëveshje duke u bazuar në vullnetin e mirë.

Në të kundërt, çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Marrëveshje, si shkeljet, anulimi ose pavlefshmëria e saj, do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Arbitrazhit, aktualisht në fuqi.

Gjykata e Arbitrazhit do të përbëhet nga tre anëtarë. Secila Palë do të emërojë një arbitër dhe anëtari i tretë, i cili do të jetë kryetari, do të zgjidhet nga arbitrat.

Neni 20

Sanksionet

Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje penalizojnë Palët sipas një vendimi të Gjykatës së mësipërme të Arbitrazhit.

Në rast shkeljeje të afatit të përcaktuar në nenin 9 pika 1, Koncesionari do t'i paguajë OSHA-së për çdo ditë vonese penalitetin 0.01% të vlerës së investimit për çdo program rehabilitimi.

Neni 21

Marrja në dorëzim e H/C

Pas miratimit të kësaj Marrëveshjeje nga Këshilli i Ministrave, marrja në dorëzim e hidrocentralit në koncesion do të bëhet brenda 15 ditëve, sipas një programi të përgatitur nga Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, Koncesionari dhe KESH sh.a.

Neni 22

Bashkëpunimi ndërmjet OSHA-së dhe Koncesionarit

Organi Shtetëror i Autorizuar dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë implementimin e projektit.

Përveç rasteve kur bien dakord me shkrim për ndonjë formë tjetër, korrespondenca do të dërgohet me letër me postë, telegram ose fax, në adresat e mëposhtme:

OSHA:
Ministria e Ekonomisë
Sherif Hoxha
Bulevardi "Zhan d'Ark" nr.2
Tiranë

Koncesionari:
Shoqëria "AMAL" sh.p.k
Lagja nr.2
Librazhd
Nr.Tel.0682385174

Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës
Agim Bregasi
Sheshi "Skënderbej" nr.2
Tiranë

President
Agim Elezi

Palët kanë pranuar këtë Marrëveshje, duke nënshkruar si më poshtë:

Për Ministrinë e Ekonomisë
Sherif Hoxha

Për Shoqërinë "AMAL" sh.p.k

Për Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës
Agim Bregasi

Presidenti
Agim Elezi

Aneksi 1

PROGRAMI I REHABILITIMIT TË HIDROCENTRALIT VENDOR XHYRË

Nr.	Rrethi	Fuqia e instaluar kw	Investimi mijë lekë			Prodhimi i energjisë elektrike mijë kwh		
			2003	2004	gjithsej	2003	2004	2005
1	Librazhd	250	2300	3250	5450	900	1500	2160

Aneksi 2

INVESTIMET PËR REHABILITIM HIDROCENTRALI XHYRË NË RRETHIN E LIBRAZHDIT

Lloji i punimeve	Vlera 000 lekë	Normat e projektimit dhe të zbatimit që aplikohen
Ndërtimore	3 060	Vendim i Këshillit të Ministrave nr.444, datë 5.9.1995
Pastrim i aluvioneve në kanal dhe në basen; argjinatura; rrugë auto për hyrje në vepër; përforcim i veprës së marrjes, dekantuesit, basenit, bazamenteve të kanalit dhe të tubacionit; mbulim i pjesshëm i kanalit; veshje e kanalit. Në godinë: suvatime, hidroizolime, dyer-dritare, shtrim dyshe, përforcim bazamentesh të makinerisë dhe kanaleve brenda, ambiente shërbimi, lyerje, instalime të brendshme hidrosanitare dhe ndriçimi.		Manualet e preventivimit
Montime		Kushtet teknike
Zgarra dhe porta hidroteknike në veprën e marrjes, dekantues dhe basen; vendosje e kompensatorëve		Vendim i Këshillit të Ministrave nr.444, datë 5.9.1995

në tubac, presionit; pajisje hidraulike dhe saraçineska, tubacione shkarkimi.		Manualet e preventivimit
	125	Kushtet teknike
Remonte mekanike		Manualet e preventivimit
Hidroturbina, rregullatori i shpejtësisë, saraçineskat mekanike dhe elektrike, xhuntot dhe kushinetat, gjeneratori, sistemi i lubrifikimit, bulloneria e bazamenteve, armaturat etj.	1 035	Kushtet teknike
Remonte elektrike		Manualet e preventivimit
Gjeneratori, reostati, kabllo të fuqisë dhe të komandimit, panelet e fuqisë, sinkronizimit, matjes, nevojave vetjake, transformatorit, pajisjeve 10 Kv, etj.	1 000	Kushtet teknike
Plotësime		Rregulloret e sigurimit
Grup kolektori për gjeneratorët, reduktor-variator për elektrosaraçineskën, panel fuqie, panel nevojash vetjake, thikë fuqie 10 Kv, reostat, mjete të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë, pajisje për dhomën e shërbimit, ndërlydhje radio.	230	teknik dhe të shfrytëzimit të hidrocentraleve
Totali i investimit për rehabilitim	5 450	

V E N D I M
Nr.487, datë 3.7.2003

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.155, DATË 13.3.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË ATASHEVE USHTARAKË DHE OFICERËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, QË SHËRBEJNË NË SHTABET E NATO-S”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.7496, datë 3.7.1991 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe të pikës 11 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.155, datë 13.3.2003 të Këshillit të Ministrave, titulli i kreut II të ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Shpenzimet për ushtarakët shqiptarë, që shërbejnë në shtabet e NATO-s dhe në përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s.”.

2. Në pikat 1, 2, 3, 4 dhe 6 të kreut II, në varësi të ndryshimit të pikës 1 të këtij vendimi, pas fjalëve “... shtabi/et i/e NATO-s ...” shtohen

“ ... dhe në përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s.”.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.488, datë 10.7.2003

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURISË SË PALUAJTSHME, QË
PREKET NGA NDËRTIMI I SHESHIT PËR DEKOMPOZIMIN E MBETJEVE URBANE NË
BASHKINË E FUSHË-KRUJËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarit, që preket nga ndërtimi i sheshit për dekompozimin e mbetjeve urbane në Bashkinë e Fushë-Krujës.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Fushë-Krujës.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të paraqitur në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi për sipërfaqe 2200 m2 tokë bujqësore në shumën e përgjithshme prej 570 020 (pesëqind e shtatëdhjetë mijë e njëzet) lekësh.
 4. Shpenzimet procedurale të jenë në shumën 25 678 (njëzet e pesë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë.
 5. Fondi prej 595 698 (pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekësh, për kompensimin e pronarit dhe për shpenzimet procedurale, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Fushë-Krujës.
 6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.8.2003.
 7. Afati i përfundimit të ndërtimit të jetë data 28.9.2003, e përcaktuar në lejen e ndërtimit dhënë nga Këshilli i Rregullimit të Territorit i Bashkisë së Fushë-Krujës.
 8. Pagesa t’i bëhet pronarit në përputhje me ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”.
 9. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Bashkia e Fushë-Krujës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E SHESHIT
TË DEPOZITIMIT TË MBETJEVE URBANE NË BASHKINË E FUSHË-KRUJËS**

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m2	Çmimi lek/m2	Vlera në lekë
1	Hysen Ramiz Alia	2200	259.1	570 020
	Shuma			570 020

V E N D I M
Nr.489, datë 10.7.2003

**PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR USHQIMIN DHE
USHQYERJEN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 41 të ligjit nr.7941, datë 31.5.1995 “Për ushqimin”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Ushqimin dhe Ushqyerjen.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

U D H Ë Z I M
Nr.106, datë 1.7.2003

PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.230, DATË 4.4.1998
“PËR PRIVATIZIMIN E PJESËVE TË KAPITALIT TË ZOTËRUARA NGA SHTETI NË
SHOQËRITË ME KAPITAL TË PËRBASHKËT”

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.230, datë 4.4.1998 “Për privatizimin e pjesëve të kapitalit të zotëruara nga shteti në shoqëritë me kapital të përbashkët”, Ministria e Ekonomisë

U D H Ë Z O N:

1. Ministria e Ekonomisë miraton fillimin e procedurës për privatizimin e pjesëve të kapitalit shtetëror në shoqëritë me kapital të përbashkët, me urdhër të ministrit.

2. Thirrja e mbledhjes së asamblesë për miratim të transferimit (privatizimit) të pjesëve të kapitalit shtetëror në këtë shoqëri, bëhet nga organi që ka në administrim pjesët e kapitalit shtetëror në shoqëri. Ai njofton me shkrim ortakun joshetëror sipas kërkesave të ligjit “Për shoqëritë tregtare”, nr.7638, datë 19.11.1992.

3. Asambleja e ortakëve, e thirrur sipas pikës 2, do të vendosë për transferimin e kuotave. Miratimi për transferimin e pjesëve të kapitalit të zotëruara nga shteti, do të konsiderohet i dhënë me vendim të mbledhjes së ortakëve. Nëse miratimi nuk është dhënë, atëherë procedurat e mëtejshme të transferimit (privatizimit) vazhdojnë sipas afateve të përcaktuara në aktet e themelimit.

4. Kur në aktet e themelimit nuk është përcaktuar afati i pritjes së përgjigjes nga ortaku joshetëror, miratimi konsiderohet i dhënë 3 muaj pas paraqitjes së kërkesës.

5. Pas miratimit të kërkesës për privatizim, shoqëria me kërkesën e ortakut shtetëror zgjedh një ose disa ekspertë kontabël të miratuar për vlerësimin e pjesës së kapitalit të zotëruar nga shteti. Miratimi i ekspertëve bëhet me vendim të asamblesë.

6. Eksperti kontabël, së bashku me shoqërinë, bëjnë mbylljen operative të bilancit, për efekt privatizimi të pjesëve të kapitalit shtetëror, ditën e fundit të muajit nga data e emërimit të ekspertëve.

7. Për rastet kur truallit është përfshirë në kapital të shoqërisë, vlerësimi do të bëhet pas miratimit të transferimit të pjesëve të kapitalit shtetëror, ortaku shtetëror duhet t'i kërkojë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme vlerën mesatare të shitjes së truallit për metër katror, sipas shitjeve të regjistruara në zonën përkatëse brenda një viti nga data e paraqitjes së kërkesës. Vlera e përlllogaritur në këtë rast do të përfshihet vetëm për kuotim të çmimit të pjesës së kapitalit shtetëror që do të shitet.

8. Në rastin kur ortaku shtetëror ka miratuar transferimin e pjesëve të kapitalit që zotëron në shoqëri dhe nëse shoqëria ka marrë vlerësimin e truallit para shfuqizimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.312, datë 30.6.1994 “Për çmimet e truallit dhe qiranë e truallit, që u jepet në përdorim

personave fizikë dhe juridikë”, të vazhdojnë procedurat e privatizimit.

9. Nëse privatizimi i kapitalit shtetëror nuk realizohet, procedura e privatizimit do të rifillojë duke pasur parasysh që në relacionin e ekspertëve të rinj, duhet të pasqyrohen rezultatet ekonomiko-financiare edhe për periudhën kohore nga mbarimi i funksionit të ekspertëve paraardhës dhe fillimit të ekspertëve pasardhës.

10. Përgatitja e dosjes dhe dërgimi i saj pranë organit shtetëror, që ka bërë thirrjen për mbledhjen e asamblesë të shoqërisë, bëhet brenda 20 ditëve kalendarike nga data e caktimit të grupit të ekspertëve.

Pas verifikimit të dokumenteve të paraqitura nga shoqëria, ky organ brenda 10 ditëve kalendarike i përcjell ato në Ministrinë e Ekonomisë. Ministria e Ekonomisë kur e gjen dokumentacionin e dosjes të rregullt, brenda 20 ditëve e dërgon atë në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit, në rast të kundërt, ia kthen organit shtetëror që ka bërë thirrjen e asamblesë duke rivendosur afatin e kompletimit të dosjes.

11. Agjencia Kombëtare e Privatizimit, brenda 7 ditëve nga marrja e dosjes, bën publikimin për privatizim. Procedura e publikimit do të kryhet brenda një intervali kohor prej 15 ditësh kalendarike. Afati i pranimit dhe hapja e ofertave nuk do të jetë më pak se 18 ditë dhe jo më shumë se 20 ditë kalendarike, pas datës së parë të publikimit. Pjesëmarrësit në ankand duhet të paguajnë kushtin e garancisë në masën 20 për qind të vlerës së publikuar. Administrimi i vlefës së kushtit të garancisë bëhet sipas klauzolave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.159, datë 13.3.2003 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet dhe procedura e shitjes”.

12. Ekspertët kontabël do të paguhën nga shoqëria, sipas urdhëresës së Këshillit të Ministrave nr.1, datë 2.10.1995 “Për organizimin e profesionin e ekspertëve kontabël të autorizuar” dhe shkresës së Institutit Kontabël nr.2411, datë 17.9.1997, i cili do të marrë përsipër të gjitha shpenzimet e procesit përgatitor të privatizimit të pjesës së kapitalit shtetëror.

13. Gjendja ekonomiko-financiare përfshin paraqitjen e llogarive vjetore që nga momenti i themelimit të shoqërisë deri në momentin e caktimit të ekspertit kontabël për fillimin e procedurës së privatizimit të kapitalit shtetëror.

14. Në paragrafin e dytë të pikës 13 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.230, datë 4.4.1998 me fjalët “... identifikuar sipas dokumenteve që kërkon ligji ...” do të kuptohet që pjesëmarrësit në ankand do të jenë të pajisur me letërnjoftim, pasaportë ose certifikatë me fotografi.

15. Në pikën 15 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.230, datë 4.4.1998 me “... ditë njoftimi ...” do të kuptohet afati jo më shumë se 3 ditë nga data e zhvillimit të ankandit.

16. Në pikën 17 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.230, datë 4.4.1998 me “... datë lëshimit të autorizimit ...” do të konsiderohet afati jo më shumë se 3 ditë nga data e përcaktimit të blerësit të mundshëm.

17. Udhëzim 2/1, datë 16.6.1998 shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Arben Malaj

SHPLLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Mbrojtjes shpall kërkesën për shpronësim publik të pasurive pronë e paluajtshme për objektin “Për ndërtimin e Qendrës Kombëtare Stërvitore Bazë (QKSB) të FA-së të Republikës së Shqipërisë në rajonin Bunavi”.

Subjekti i këtij shpronësimi është Ministria e Mbrojtjes (Drejtoria e Ekonomi-Privatizimit).

Me anë të këtij publikimi ne kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Shpronësimit pranë Ministrisë së Mbrojtjes, për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

Republika e Shqipërisë
Qarku Vlorë

LISTË-PAGESA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR SHKAK TË NDËRTIMIT TË
QENDRËS KOMBËTARE STËRVITORE BAZË (QKSB) TË FA-SË TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË RAJONIN BUNAVI

Lloji i pasurisë së paluajtshme: tokë bujqësore. Nr.1-11

Z. K	Nr.	Pronari		Mbiemri	Nr.pas.	Tokë bujqësore		Vlera në lek	Vlera në lek për t'u paguar	Shënime squares
		Emri	Atësia			Sip. Shpr. m2	Çmimi në lek/m2			
1	1	Aleks	Pavlo	Dëma	106/8	2000	500	1000000	1000000	
3	2	Todi	Llambro	Kaçani	106/9	1750	500	875000	875000	
1	3	Vasil	Nasho	Tita	106/10	750	500	375000	375000	
6	4	Novruz	Sabri	Tahiri	106/11	7000	500	3500000	3500000	
B		Novruz	Sabri	Tahiri	113/11	4750	500	2375000	2375000	
U	5	Elez	Sabri	Tahiri	113/9	3680	500	1840000	1840000	
N	6	Abedin	Sabri	Tahiri	113/10	6200	500	3100000	3100000	
A		Abedin	Sabri	Tahiri	113/12	6450	500	3225000	3225000	
V	7	Ligor	Marko	Dëma	106/12	4000	500	2000000	2000000	Pa tapi
I	8	Fatmir	Rrustem	Mamo	106/13	2000	500	1000000	1000000	Pa tapi
Shuma						38580		Shuma	19290000	

Shënim: Mbyllet me numrin rendor 8 (tetë)

K Ë R K E S Ë

Vera Loshi, e datëlindjes 1972 me banim Konaj-Fanë, Mirditë, kërkon të shpallet i zhdukur bashkëshorti i saj, Petrit Loshi.

KËRKUESE
Vera Loshi

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

Doli nga shtypi më 21.7.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë